



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 01-060/01-0044/07/24
Data 09/09/2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 22.07.2024, në ora 11:00, në sallën e bordit të drejtoveve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmuor janar-qershor 2024, me Nr.04-052/01-0032374/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, me Nr.04-400/01-0032372/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
7. Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr. 07-030/03-0032405/24, të datës 10.07.2024, (Raporton drejtori i DKA-së, **z. Kastriot Duraku**);
8. Të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar KPF-së, kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 4 anëtarë të KPF-së, mungon me arsye Besiana Thaçi, ndërsa bashkëngjitet gjatë mbledhjes Ilir Ejupi.

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (0) abstënim, miratohet Rendi i ditës, ju njoftojmë së Ilir Ejupi është bashkëngjitur mbledhjes.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstënim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmuor janar-qershor 2024, me Nr.04-052/01-0032374/24, të datës 10.07.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Raportin financiar gjashtëmuor janar-qershor 2024, është raport i rregullt çdo 3 muaj, ky është raporti i dytë për këtë vite, disa ndryshime që kanë ndodhur nga raporti i partë janë shtuar 179,566.17€, që janë pjesë përbërës e buxhetit, deri në fund të vitit, që në total kemi një buxhet 18,761,876.17€, duke u menaxhuar. Pjesë tjetër shtesë janë edhe të hyrat vetanake janë realizuara 52.69%, buxheti është shpenzua 57.65%, në paga e shtesa është shpenzuar 62.76%, mallra e shërbime është shpenzuar 54.08%, shërbime komunal është shpenzuar në 47.74%, subvencione 61.06%, dhe në investime kapitale në 47.36%. Në faqen 8 janë llojet e shpenzimeve sipas kategorive e nen kodeve, neper të gjitha kategoritë të krahasuara në dy vitet paraprake me të njëjtën periudhe. I keni listën e

projekteve kapitale, si dhe shpenzimet sipas drejtorive dhe zyrave, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, drejtor e kam një pyetje jashtë këtij raporti që ndërlidhet me raportin, të hyrat vetanake të gjeodezisë e kadastrë a ka implikime që janë dukshëm, në të hyrat vetanake apo nuk ka?

Ilir Ejupi-IDEAL: Fjala përshëndetëse, drejtor i kam disa pyetje të kategoria e shpenzimeve që janë disa rritje, të shpenzimet e internetit, shpenzimet e telefonit, furnizimi me pije, shpenzimet të kategoria e druve për ngrohje, a kanë shtarim drejtor perse janë këto rritje të këto kategori?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Faleminderit, të hyrat e gjeodezisë e kadastrit kanë implikime janë pjesë e të hyrave vetanake të komunës që ndikojnë në pjesën që komuna është e obliguar për me inkasua. Sa i përket shpenzimeve që i përmendi Iliri, pjesën me të madhe të shpenzimit për ushqim e pije e përben shtëpia e pleqve dhe çerdhja.

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Shpenzimet e internetit, është kontratë komplet e arsimit që është lidhur tani, që është rritë shpejtësia e internetit neper të gjitha shkollat e komunës tonë, dhe për atë është rritë edhe shpenzimi të kategoria e internetit.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmuor janar-qershor 2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Para vetes e keni, Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023. Është një raport që është hartuar nga zyra kombëtare e auditorit, një obligim ligjor që i nënshtrohet çdo organizate buxhetore këtij procesi. Raporti ka pas vlerësim maksimal për komunën tonë, raporti është i pamodifikuar, është dorëzuar edhe plani i veprimit për ato të gjeturat që kanë qenë disa të gjetura teknike të përsëritura, po nuk kanë ndikuar në opinion dhe opinionin është maksimal.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Skenderajt për vitin 2023, me Nr.04-47-899/1, të datës 20.06.2024, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm 2023.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, me Nr.04-400/01-0032372/24, të datës 10.07.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Para vetes e keni Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024, që i shtohen buxhetit aktual dhe destinohen në fondin e bashkëfinancimit në kodin 43870, që i kemi disa kontrata të lidhur për bashkëfinancim me DEMOS-in e MAPL-në si Asfaltimi i rrugës në Klinë të Poshtme, Makerrmal, Ticë, Kopiliq i Epërme, Rakinicë, Ndriçimi publik në qytete, si dhe pajisje për Eko-Natyren.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstënim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për bartjen e mjeteve të pashpenzuara të hyrave vetanake nga viti 2023, për shpenzim në vitin 2024.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës:

-Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, me Nr. 07-030/03-0032405/24, të datës 10.07.2024, (Raporton);

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku; Para vetes e keni Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024, sipas planit të punës së drejtorisë së arsimit, janë realizuar gjitha aktivitetet që janë parapa për këtë gjatë mujorë, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstënim rekomandohet për kuvend për përkrahje Informatë për aktivitetet e Drejtorisë së arsimit për periudhën janar-qershor 2024.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, fjalën ja kaloj;

Ilir Ejupi-IDEAL: E kam një pyetje kryesuese, a ka me ardhur në këtë seancë raporti i Kompanisë Uniteti, që është shtyrë në seancën e kaluar?

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka vazhdojmë, po Ilir në këtë seancë e keni raportin e kompanisë Uniteti që është shtyrë seancën e kaluar, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, që mbahet me 30.07.2024, në ora 10:00 gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit